

Takimi i Antarëve të Bordit EITI

|MINUTES

Data e takimit | Ora 1/28/2014 11:00 AM | Vendë takimi *Ministria e Energjisë dhe Industrisë*

Takim i thirrur nga
z. Ilir Bejtja

Të pranishmit

z. Mehmet Hasalami, MEI
z. Dritan Spahiu, MEI
znj. Arjana Dyrmishi, MF
znj. Tetis Lubonja, MD
z. Bislim Boshnjaku, Shërbimi Gjeologjik
Shqiptarë
z. Ilir Aliaj, ShC
znj. Anila Hajnaj, ShC
z. Sami Nezaj, ShC
z. Erald Kapri, ShC
z. Omer Dashi, Bankers Petroleum
z. Përparim Alikaj, FIAA
z. Fatbardh Ademi, Stream Oil
znj. Dorina Çinari, AlBEITI
z. Agim Shehu, AlBEITI
z. Albert Brojka, AlBEITI
z. Llambro Hallkaj, AlBEITI
z. Erion Isaraj
znj. Arlinda Rumbullaku

PIKA PER REND IDITE

1. Miratimi i Planit të Punës 2014
2. Miratimi i ToR

znj. Dorina Çinari Unë jam drejtoresha e re e Sekretariatit Shqiptar EITI. Quhem Dorina Çinari dhe jam diplomuar në inxhinieri elektronike, ku kam punuar për shumë vite në, natyrisht kjo është eksperiencia ime e pare në një organizatë po themi shtetërore, shpresoj të deversifikoj eksperiencat e mia në shërbim të punës. Jam shumë e kënaqur që po ju takoj të gjithëve dhe shpresoj që do kemi një bashkëpunim të mirë dhe në këtë moment është shumë e nevojshme. Jane ca momente që janë bërë e nxehta tani për sa i përket fateve të EITI-it.

z. Mehmet Hasalami Unë jam këtu me porosi të zv. Ministrit z.Bejtja, për të qënë prezent dhe për të organizuar bashkarishtë këtë mbledhje. Rendin e ditës besoj e keni të gjithë përpara dhe unë mendoj që disa nga gjerat që janë te qarta te mos i diskutojmë më dhe të ngelemi në problemet që realisht siç tha dhe drejtoresha janë pika të nxehta për të vënë duart në ato probleme dhe në ato etapa që bëjnë të mundur zhvillimin e më tejshëm ose zhvillimin e projektit. Tani lidhur me raportin ju do thoni nja dy fjalë apo ska nevojë?

znj. Dorina Çinari Nese e keni lexuar dhe keni ndonje pyetje?

z. Mehmet Hasalami Tani ideja është që ta bëjmë pak më kreative që të mos bëhemi të bezdisshëm, të flasim vetëm për gjërat që janë megjithë mënd për tu kontrolluar apo përmirësuar, çfarë do shtohen dhe kanë nevojë.

znj. Dorina Çinari Nentor-dhjetori nuk ka patur ndonje aktivitet shume masiv, me teper ka qene parapergatitje per vitin 2014. Janë përgatitur termat e referencës për përgatitjet e raporteve EITI 2011 dhe 2012. Ka pasur komunikime me ministritë prespektive për përgatitjen e marrveshjes së grandit të BB, gjithashtu për buxhetin e vitit 2014 dhe ky ka qënë pak a shumë aktiviteti i nentor-dhjetorit. Nëse keni ndonjë pyetje të veçantë ju lutem. Tani meqenëse përmenda buxhetin, nesor në takimin e radhës të Këshillit të Ministrave është në axhendë aprovimi i grandit të BB, që është 300 mijë \$ dhe që është shumë i rëndësishëm për aktivitetet e EITI pasi do na mundësojë përgatitjen e raportit, do na mundësojë aktivitetet e tjera të komunikimit, të trajnimeve, të ngritjes së kapaciteteve nëpër zonat prodhuese pra jemi shumë në pritje të nxehte kur i thonë. Shtetit ka aprovuar një buxhet më një fond prej 10 milion lekë për vitin 2014 rreth 33% më shumë se buxheti i vitit 2013 që do të thotë jemi pozitivisht edhe në këtë pikë. Natyrisht EITI, i fton të gjithë ata që mendojnë se mund të kontribojnë, në çfarë do llojë formë, në financimin e aktiviteve. Është akoma raporti i vitit 2014 i pa përcaktuar se si do të financohet ndërkohë që duhet të perfundohet brenda vitit 2014, më falni raporti 2012 EITI. Nuk e di në isha e qartë.

z. Mehmet Hasalami E di pse jemi ne pak kështu, se në përgjithësi është se disa vendime ose disa gjëra ngushtohen të merren në mënyrë shumë të shpejt. Dhe në përgjithësi besoj që nuk është shumë praktikë e mirë kjo që nesor ose pasnesër është marrë vendimi për financimin dhe ne të mbidhemi sot. Në kuptimin që nuk është ndoshta vetëm dhe ndryshimi i drejtuesve që dhe mund të ketë ndikuar sepse si do që të jetë, sa do angazhim të ketë drejtoresha e re ka gjëra që të lëvizin me shpejtesi. Ndaj herë tjetër të paktën mirë është edhe materialet dhe vendimarrja të bëhet në kohën e duhur dhe pa ngutje.

Ne në takimin e parë kemi kërkuar dhe gjithë ata që ishin pjesëmarrës që ky projekt të ketë realisht një vlerë aplikative në të gjitha ato parametra që ishin përcaktuar por jo thjesht një projekt për projekt ose thjesht për tu studiuar apo thjesht për tu afishuar, prandaj duhet diçka më konkrete. Megjithatë kolegu ka thënë mendimin që megjithë mend ky projekt të jetë më konkretë, shumë më konkretë sepse ne nëse bëjmë një punë shumë të mirë, orientojmë shumë mirë, natyrisht ky do ketë edhe vitin tjetër financime shumë herë më të medha. Se për shembull nëse ky projekt është thjesht pak a shume siç ka qënë deri tani, do të thotë që ky projekt normalisht nuk do financohet më. Është detyrë e qeverisë shiptare që të cakton disa drejtime që ti je i detyruar ti zbatoshë.

znj. Dorina Çinari Natyrisht prandaj jemi mbledhur dhe këtu sot.

z. Ilir Aliaj Më fal a mund të flas dhe të ri-prezantohem edhe njëherë. Unë jam Ilir Alij përfaqësoj një nga organizatat e shoqërisë civile që janë pjesë e këtij bordi. Unë desha të falenderoj sekretariatit për këtë mbledhje, e cila është një mbledhje shumë e rëndësishme për dy faktorë. Faktori parë është se shumë shpejt do të merret vendimi për kërkesën e Shqipërisë për ta shtyrë apo jo kohën për prezantimin e raportit dhe faktori dytë shumë i rëndësishëm i kësaj mbledhje është angazhimi i Shqipërisë pra i sekretariatit dhe i joni të gjithve për bërjen e dy raporteve brenda këtij viti. Mua më duken gjëra shumë të lehta edhe se janë dy raporte brenda një viti. Por realisht dy raporte brenda një viti janë si kohë shumë e shkurtër dhe kërkon një angazhim shumë të madh dhe serioz nga të gjithë ne dhe në rradhë të parë nga sekretariati. Duhet theksuar fakti që AlBEITI dhe në të kaluarën por edhe besoj me angazhimin e drejtueses së re ka qënë një projekt i sukseshëm dhe do jetë një projekt i sukseshëm. Prandaj unë nuk shoh ndonjë arsye për skepticizëm për projektin vetëm se duhet të jemi pak më të shpejtë. Dhe është lajmë i mirë që nesër në mbledhjen e qeverisë do të miratohet pra gandi i BB. Sigurisht që këtu duhet të jemi pak të kujdesshëm sepse vërtet miraton qeveria por duhet të kthehet në bankë për ratifikim pra do na marri dhe një pjesë tjetër kohe. Kjo është një procedurë e zakonshme dhe topi është gjithmonë në krahun tonë sepse banka e ka sjellë këtë grand për miratim që në muajin qershor, me sa di une dhe sot jemi në fund të janarit.

znj. Dorina Çinari Një ditë përpara *djegies* së afatit.

z. Ilir Aliaj Ata nuk duan të dinë shumë në është ndërruar apo nuk është ndërruar qeveria, është ndërruar apo nuk është ndërruar ministri apo drejtues të tjerë. Ata duan të dinë që kanë të bëjnë me qeverinë Shqiptare. Dhe kjo na vë ne përpara shumë angazhimeve shumë serioze. Edhe njëherë, une them a duhet ta përkrahim shumë sekretariatit në këtë angazhim shumë të vështirë që ka marrë përsipër për realizim e dy raporteve brenda një viti? Kjo është ajo çfarë kisha unë për të thënë.

znj. Dorina Çinari Nga ana e BB unë kam pasur shumë korrespondenca intensive ditët e fundit. Ata kanë një angazhim shumë serioz dhe më kanë marrë vete në telefon disa herë në ditë dhe me kanë thënë vetëm kaloni grandin dhe do keni suportin maksimal nga ana jonë për të përshpejtuar

çdo procedurë. Domethënë dhe ata e kuptojnë rëndësinë dhe momentin në të cilën ndodhet EITI. Kështu që meqënëse, dueshe ndarë dhe ky infomacion po e themi, për të qënë transparentë. Duke qënë se bordi do të këtë antar të rinj, gjithashtu është ofruar mundësia e një trajnimit të antarëve të bordit nga ana e BB mbi proçeset EITI. Se çfarë është EITI, si funksionon EITI, rëndësinë EITI etj. sepse dhe vetë antarët e qeverisë nuk e kuptojnë, grupet sociale nuk e kuptojnë thelbin, rëndësinë dhe vete proçesin. Mund të bihem dakort këtu për një raund trajnimit gjatë muajit që vjen. Ata do vinë vetë këtu në Tiranë, përfaqësuesit e bankës botërore por më thanë që ta përmënd në mbledhje, ta ofroj si mundësi pasi është një mundësi e mirë për të kuptuar diçka nëqoftëse shkurti është një muaj i mirë për të gjithë.

z. Ilir Aliaj Po patjetër

znj. Dorina Çinari Trajnimi mund të jetë një ditë apo dy ditë maksimumi për principet EITI, si funksionon EITI, kush janë standartet EITI, kush është morali, etj.

z. Ilir Aliaj Zakonisht trajnimi është dy ditë dhe ata sjellin vetë një trajner.

z. Përparim Alikaj Po, janë bërë edhe në të kaluarën këto.

znj. Tetis Lubonja Quhem Tetris Lubonja nga ministria e drejtësisë. Unë kam një ngërç le të themi sepse e dimë që në jemi antar të këtij bordi duke pasur parasys urdherin e ish kryeministrit. Unë mendoj që urdhëri duhet ribërë, për prezencën dhe ndoshta dhe rikonfirmimin. Unë e kam kërkuar edhe me email këtë gjë.

znj. Dorina Çinari Po e lexova.

znj. Tetis Lubonja Rikonfirmimin nëse jemi apo sjemi më antare bordi?

znj. Dorina Çinari Në urdherin e tij Kryeministri nuk ka përcaktuar emra personash. Ka përcaktuar cili institucion do përfaqësohet në bord. Emrin e personit e përcakton titullari i institucionit tuaj dhe në jemi në procesin e komunikimit zyrtar me të gjitha institucionet. Kjo dihet se si funksionon dhe kur të vjen përgjigja dhe në nuk mund të presim një muaj, titullarin e institucionit për të përcaktuar një emër në bord pasi në kështu nuk mblidhemi dot kurrë. Prandaj derisa ju e keni marrë një detyrë, derisa sa jeni antar të bordit

znj. Tetis Lubonja Patjetër, prandaj jemi dhe këtu

znj. Dorina Çinari Ose do thone do të vazhdoni të jeni dhe pse të mos jeni dhe do të vazhdojmë të mblidhemi sepse e keni atë status, apo jo?

znj. Tetis Lubonja Ok por mos na vjen shkresa dhe nuk marrim vesh gjë për shembull, se institucionet tona janë plot me shkresa

znj. Dorina Çinari Nuk do merrni vesh antaresimin në bord?

z. Mehmet Hasalami Tani mos na shaj institucionet

znj. Tetis Lubonja Jo po them qe jemi plot me shkresa prandaj po them se jemi te gjithë te mbytur neper punera dhe te them te drejten une tani duhet te largohem faktikisht sepse po me pritet nje material qe duhet te jete per kryeministrin.

znj. Dorina Çinari Ok neqoftese ke per te bere nje koment ne lidhje me materialet qe jane pergatitur, neqoftese ke ndonje kundershtrim. Njoftimin per antaret e bordin do jua bejme ne. Pervec komunikimeve zyrtare midis institucioneve ne do ju njoftojme drejt per drejt, per te shkurtuar te gjithë keto. Por per qellimin qe jemi mbledhur ne takim sot nese keni ndonje kundershtrim, sygjerim?

z. Mehmet Hasalami A ka ndonje verejtje lidhur me piken e pare te rendit te dites me miratimin e programit te punes EITI per vitin 2014? A ka ndonje verejtje? Pra lidhur me kete qe eshte pika e pare. Une kam verejtje ta shohim.

znj. Arjana Dyrmishi Une jam Arjana Dyrmishi, drejtore per politikat fiskale ne Ministrine e Finacave. Lidhur me piken e pare te rendit te dites sepse do te aprovojme planin e punes per vitin 2014. Do te doja nese une nuk e kam kapur apo nese une nuk e kam lexuar, pjese e projektit grand me BB ka qene nje kerkese e ministries se finances per nje komponent nga ky projekt per te ardhurat per industria nxjerrese.

znj. Dorina Çinari Po eshte

znj. Arjana Dyrmishi Dhe nuk po e shoh realisht se si eshte shtjelluar dhe afati dhe nese me ndihmoni me nje reference. Te plani i punes une nuk po e shoh.

znj. Dorina Çinari Ndoshta ajo nuk eshte shprehur aty por eshte ne planin e prokurimit te bankes boterore. Eshte I planifikuar si aktivitet. Afatet jane ne konfirmim me banken por llogaritet diku ne 6 mujorin e pare.

znj. Arjana Dyrmishi Ne 6 mujorin e pare per 2014.

znj. Dorina Çinari Po

znj. Arjana Dyrmishi Por derisa nuk eshte ketu dhe ne rast se ne e miratojme duhet ta bejme me nje shenim. Sepse Bordi do miratoj programin e punes 2014. Atehere une do te propozoja qe ta shtonim kete sepse ka qene nje nder komponentet e diskutuar.

z. Mehmet Hasalami Te cila pike duhet ta shtojme ne kete

z. Agim Shehu Eshte e perfshire

z. Mehmet Hasalami Mbani shenim jemi dakort?

znj. Arjana Dyrmishi Te plani i punes faqja 7.

z. Mehmet Hasalami Beni shenimin e duhur, te cila pike?

znj. Arjana Dyrmishi Ka qene jo te monitorimet por te analiza

znj. Dorina Çinari Ai ka qene raporti i kapaciteteve prodhuese ose analize. Aty eshte shprehur kapacitete prodhuese dhe eshte ne raport dhe eshte nje nga zerat ne plan prokurimit te BB.Ka nje buxhet te planifikuar per ate.

znj. Arjana Dyrmishi Po pra se ai eshte komponenti qe na intereson.

znj. Dorina Çinari Afatet nuk jane konfirmuar nga banka boterore

znj. Arjana Dyrmishi Por per keto te tjerat jane te konfirmuara se jane pjese e planit?

znj. Dorina Çinari Kemi cuar kalendarin dhe nuk kemi mare "objection" qe te na vij konfirmimi nga BB qe nuk kemi asnje objeksion lidhur me afatet qe keni propozuar ju.

znj. Arjana Dyrmishi Atehere kjo eshte vetem per kete komponent sepse per elementet e tjere ne kete plan jane te gjitha shume prej ketyre aktiviteve pjese per grandin me BB. Pra keni marre ok per te gjitha aktivitetet dhe skeni mare ok vetem per keto komponent.

znj. Dorina Çinari Komponentin po e shtojme tani. Flitet per 6 mujorin e pare te 2014.

znj. Arjana Dyrmishi Ok

z. Mehmet Hasalami Ta saktesojme qe ketu dhe te mos e diskutojme me dhe te ripunohet materiali e te shtohet. Tjeter ka ndonje problem lidhur me piken e pare. Kjo pika e pare ka edhe miratimin te planit te punes per vitin 2014 a e lexoni? Se eshte perfshire edhe raporti i 2011 dhe 2012, ne fund. Kjo eshte projekt vendimi dhe te projekt vendimi pika nje pervec miratimit te planit per 2014 te punes, perfshihet edhe raporti 2011-2012.

znj. Arjana Dyrmishi Te beje nje pyetje sepse per kete jemi mbledhur. Te faqja e trete thuhet te pika 2b. garantimi i fondit per 10 milion leke ne vit per aktivitetet EITI per financimin nga buxheti i shtetit per vitin 2014. Buxheti eshte miratuar, garantimi cfare do te thote, ju i keni 10 milion leke. Ju thoni garantimi i fondit, ne cfare konteksti se ne buxhetin e shtetit ju e keni 10 milion leke dhe ne baze te zerave buxhetor ju do i shpenzoni per aktivitete. E ke te garantuar se eshte miratuar me ligj.

z. Mehmet Hasalami Arjana te cila faqe eshte, te lutem?

znj. Arjana Dyrmishi Eshte te faqja 3 pika 2b. Garantimi eshte bere me ligj.

z. Agim Shehu Duke dashur te sqarojme dicka me shume per cka ngriti zonja Dyrmishi te faqja 7 dhe faqja 8 ndoshta duhet permiresuar ne terminologji por BB persa i perket studimit te perbashket.....jane pasqyruar te faqja 7 dhe vazhdon te faqja 8. Ndoshta do permiresuar por kjo eshte per pyetjen e pare. Per pyetjen e dyte do te desha te sqaroj se pika qe eshte vendosur te

faqja 3 qe thuhet nga garantimi duhet te sqarojme ndoshta edhe grupi punes ketu, faktikisht mund te jete miratuar me buzhet por ju nuk e dini qe sekretariati ka nje muaj qe eshte pa paga dhe nuk eshte garantuar sepse nuk po gjendet ne buzhet se si do te behet kalimi eshte kaluar te fondi i investimeve te cilat nuk jane celur. Pra Ministria e Financave me Ministrine Energjise dhe Industrise akoma nuk po e sqaron se si do te zgjidhet problemi i 10 milion lekeve per vitin 2014 . Prandaj e kemi lene si garantim, na u tha nga shteti e dhene si shifer por faktikisht nuk po gjendet me veprime perkatese duke perfshire dhe thesarin.

znj. Arjana Dyrmishi Pse 10 milion leke ka kaluar si fond per investime per MEI?

znj. Dorina ÇinariEshte nje ze te cilin nuk e kalojme dot keshtu kollaj duhen disa artifica..

z. Agim Shehu Prandaj eshte vene ajo fjala garantim

znj. Arjana Dyrmishi Shiko te 7 dhe 8, tani e lexova me shume vemendje. Ajo cfare doja te thosha te pakten sic e kam kuptuar une.....sic ka qene....midis EITI dhe MinFin...ka qene jo thjesht analiza, ja ku e ke studimet qe permenden, studime qe ...duke siguruar keshilla mbi zonat e sektorit te naftes...pra nuk ka qene ne efekt te monitorimit nxjerrjes ka qene nje komponent me vete per analizen e te ardhura te ketij sektori. Kaq te sakte une nuk e gjej

z. Agim Shehu Atehere do ta vendosim

znj. Arjana Dyrmishi Dakort kete isha duke thene te faleminderit.

znj. Dorina Çinari Studimi quhet revenue potential study dhe eshte ne grupin d. sector studies

znj. Arjana Dyrmishi Po kete isha duke thene

z. Përparim Alikaj Mund te beje edhe une nje pyetje? Une jam Perparim Alikaj I FIAA-s. Tani e kemi ngritur shpesh here kete shqetesimin qe kemi per komunat.Dhe ketu marr shkas nga kjo ne faqen 8, transparenca ne te ardhurat e realizuara ne zonat e industrise nxjerrrese. Meqenese eshte edhe zonja Arjana, mund te na thote ndonje gje me konkrete se ceshte bere sidomos gjate vitit te fundit qe eshte marre dhe vendimi i qeverise qe 25% e royalties ti kaloje komunave. Akemi ne ndonje gje te tille konkretisht? Se une shoh qe ne komunat qe une punoje nuk e kane idene per kete pune...ky eshte defekti jone si AlbEITI. Por mund te kete problemet dhe gjynahet e saja edhe Ministria e Financave. Tani kemi ndonje informacion per kete ju lutem?

z. Ilir Aliaj Me fal per te vazhduar ne kete linje, ne takimet qe ne kemi bere vazhdimisht me rajone te ndryshme eshte ngritur si problem dhe ka komuna qe nuk e dine aspak qe ekziston EITI ose ka ndodhur gjate viteve qe i kane zvogeluar grandin dhe i kane thene atyre komunave qe kane kerkuar grandin se do ju japim 25% e rentes minerare. Cka nuk eshte keshtu, pasi ligji nuk e parashikon. Ligji nuk e parashikon keshtu, lishi eshte 25% e grandit shkon,, Pra ky eshte nje problem dhe duhet.

znj. Arjana Dyrmishi Shqetësimi është plotësisht i saktë. Une do të japë një përgjigje të përgjithshme se është një drejtori tjetër në MinFin e cila ka të dhëna konkrete të këtyre shumave që kanë marrë. Udhezimi për taksat kombëtare specifikon që 25% e të ardhurave nga renta bashkive ose komunave do të marrin të lidhur me pjesën e grantit që ka marrë ajo bashki ose komune. Kjo është e specifikuar në udhëzim nga drejtorja perkatese. Une e di që procedura është e përcaktuar me një udhëzim të qartë dhe ka bashki dhe komuna të cilat e kanë marrë. Ju thashë që është drejtorja e përgjithshme e buxhetit në bazë të udhëzimit si institucion e ngarkuar me akte nën ligjore për të ndjekur gjithë procedurën. Në pozicionin që jam në ministri nuk e kam këtë informacion të ta them për momentin. Në rast se do të deshironi për vitin 2013 une e kërkoj dhe ju dërgoj me email të gjithë antareve. E di që është problematik, është goxha problematik e theksuar për bashkitë dhe komunat dhe në udhëzimin për taksat kombëtare që duhet të jenë botuar në fletoren zyrtare javën e kaluar është bërë pikerisht edhe një ndryshim edhe i kesaj formule me qëllim që ti jepën bashkive dhe komunave me shumë hapsirë për të marrë të ardhura nga renta edhe këte edhe atë.

z. Ilir Aliaj Është interpretim ligjor. Me ligj thuhet që ky 25% i shkon direkt atyre, ndërsa me ligj udhëzimi është me poshtë se ligji.

znj. Arjana Dyrmishi Udhezimi e ka kufizuar sepse ligji thotë se 25% e të ardhurave nga renta i shkon bashkive dhe komunave ku është pasuria nxjerrëse. Ateherë udhëzimi e ka të kufizuar edhe është kufizuar nga strukturat perkatese, sepse i takonte në bazë të një analize që u bë nga strukturat perkatese, i takonte që një bashki ose një komune mund të merrte 25% e atyre të ardhurave, përsëmbull për zonat, që të mos përdor emra, e kompanive të mëdha naftë nxjerrëse, mund të takonte 6 mil one euro.

z. Përparim Alikaj Në përsëmbull

znj. Arjana Dyrmishi Juve po

z. Ilir Aliaj Pse mos të shkojnë atyre zonave?

znj. Arjana Dyrmishi Kjo ka qenë politika që është ndjekur

z. Ilir Aliaj Bulqiza përsëmbull është zona më e pazhvilluar në Shqipëri

znj. Arjana Dyrmishi Une të dhashe shpjegimin dhe ja u bera parantezen që nuk jam marrë une me këte çështje.

z. Ilir Aliaj Mire ...

z. Mehmet Hasalami Nëse ligji e përcakton saktësisht kush është ..., ligjet udhëzimet janë...

znj. Arjana Dyrmishi Është me udhëzim dhe është e lidhur me buxhetin e shtetit

z. Mehmet Hasalami Por udhezimi nuk mund te kundershtoj ligjin

z. Ilir Aliaj Nuk eshte ligji te udhezimi kete po thote

z. Mehmet Hasalami Apsolutisht ligji te jep ulla ku ti mund te levizesh dhe e mbyll hesapin, nuk te lejon qe ti te dalesh jashte ligjit...nuk na lejohet ne te dalim jashte tij, nese ligji e le hapshire eshte gje tjeter qe ne e interpretojme

znj. Arjana Dyrmishi E ka te kufizuar

z. Mehmet Hasalami Arjana e kufizon ligjin apo udhezimin?

znj. Arjana Dyrmishi Udhezimi, udhezimi e ka kufizuar shperndarjen....

z. Ilir Aliaj Na fal se nga kjo na lind nje pyetje tjeter, po e leme ate interpretimin ligjor, ligji apo udhezimi po merremi thjesht, keto zona nafte mbajtese a marrin grand 6 milion dollar ne vit?

z. Mehmet Hasalami Jo nuk e marrin

z. Ilir Aliaj Jo se besoj qe e marrin, po pse se marrin? Eshte gjynah edhe ata duan te zhvillohen,. Si komunat nga Patosi apo Bulqiza jane komuna te pazhvilluara.

z. Dritan Spahiu Me falni qe nderhyj,une jam Dritan Spahiu drejtor i naftes prane ministrise. Kam pershtypjen se ato kane pagesa te prapambetura ndaj MinFin dhe prandaj nuk e marrin ate pjesen e rentes.

znj. Arjana Dyrmishi Jo jo nuk eshte kjo

z. Përparim Alikaj Nuk ka lidhje kjo fare, pergjigje e gabuar.

znj. Arjana Dyrmishidrejtoria e buxhetit

z. Sami Nezaj Ceshtja eshte qe udhezimi e ka nderlikuar shume punen e marrjes se ketyre parave nga komunat dhe bashkite ku udhezimi...

z. Mehmet Hasalami Une mendoj qe ligji i ka lene hapsirat e mundeshme qe te dali ky udhezim perndryshe. Mendoj qe ligji ka udhezuar strukturat poshte ta beje, ka lene hapshire se nuk ka mundesi qe nje udhezim ti dali kryq ligjit

z. Omer Dashi Zoti Hasalami une jam Omer Dashi nga bankers peltroleum, kam qene pjese e EITI-it qe nga fillimi. Udhezimi ka dale mbasi u be kjo per llogaritje qe disave u binte me te vertete shume. Te ndryshohet ligji

z. Mehmet Hasalami Tani ne aq sa njohuri juridike kemi, nuk mund te /....

z. Ilir Aliaj Edhe udhezimi vete nuk qendron se nuk i jepen 6 milion dollar atyre. Asnje grand nuk i shkon.

z. Omer Dashi une jam shume dakort edhe ne rast se i jepen ..rentes tone minerate qe eshte ..komunat e Shares te behen si nje mini Las Vegas.

z. Përparim Alikaj Pse te mos i marrin, shume mire

z. Omer Dashi Ne ku ta gjejme qe ata ti marrin

z. Mehmet Hasalami Te detyrat do ta leme saktesisht per tu azhornuar ligji dhe te gjitha udhezime qe dalin ne baze te ketij ligji.....

z. Përparim Alikaj Shume e drejte une kete kisha

z. Omer Dashi Kjo eshte shume e drejte

z. Mehmet Hasalami Te ndryshohet ligji, per tu pershtatur nese ka ndonje gjykim tjeter

z. Sami Nezaj Te ndryshoje qe ti marrin vete ata sepse MinFin e ka aftesine ti ngateroj dhe ti beje lemsh komunat dhe bashkite per terheqjen e parave...

.....

znj. Dorina Çinari Nje vend e percakton vete se kush jane keto asete natyrore te cilat do ti beje transparence. Ka vende qe kane peshkimin, pra ne transparence perfshin vendi vete ato burime natyrore qe vendi gjykon si asete te medhaja kombetare dhe qe do ti beje transparence, se cila komitete perfitojne, sa perfiton shteti dmth jemi ne qe e vendosim se cila asete do te vendosim te perfshijme ne transparence.

z. Mehmet Hasalami Eshte politika pak me e gjere se kaq qe do i vendosi keto terma sepse ne realisht synojme vetem per pasyrite natyrore per keto qe jane minerale, nafta.....

z. Ilir Aliaj Me fal ne kemi kerkuar edhe transparencen e koncesioneve te hidrocentraleve, ne mbledhjet me perpara, kemi kerkuar edhe transparencen e TAP-it neqoftese do u miratonte si projekt qe sot u miratuat. Ne ate kohe qe sishte i miratuar TAP-i, qe fliteshe do te miratohet apo nuk do te miratohet edhe koncesionet e hidroncetrleve sepse uji eshte burim, pasuri kombetare. Tranziti i gazit, pra TAP-i eshte pasuri e te gjithëve dhe jo e dy vetave.

z. Mehmet Hasalami Ne si grup ketu gjykojme vetem per kete pike, dhe e kemi te kufizuar ...por per te gjykuar me gjere duhet detyrimisht ata qe e bejne politiken se ne jemi te vegjel, absolutisht duhet te gjejne me te patjeter nje gredient ku te kenaqet me te gjitha pasurite. E thashe edhe njehere e zeme nje pasuri ujore, pyjore etj qe nuk kane lidhje direkt me kete dhe

duke e shperndare me 20-30 % fjala vjen te Fierit ne e demtojme po marrim, nje rast kot te Tropojes....

z. Ilir Aliaj Po Fierin e marrim, skemi ndonje gje me Firin ne

z. Mehmet Hasalami sepse aty jane 1000 hektar te mbyllur , po e diskutoj thjesht per tu kuptuar, jane 1000 hektar qe ajo zona atje e ndjen ne kurriz, do te thote ti perfiton miliona euro se eshte pasuri dhe vendet atje e zeme...ne shperndarjen e te gjithë ketyre te ardhurave. Dhe ndoshta udhezimi, ligji ja ka lejuar udhezimit qe e zeme te mos ja japi komplet nje komune e jete...

z. Ilir Aliaj Jo Jo me fal, parimi baze i EITI-it eshte qe pasurite ti kthehen mbrapsht atij komuniteti ku eshte pasuria dhe ne ketu vertet nuk mund te arrijme te bejme politika te medha por ne duhte tja transportojme atyre qe bejne politika te medha.

z. Mehmet Hasalami Apsolutisht qe po

z. Ilir Aliaj Ne duhet t'ia themi atyre qe ky eshte parim i EITI, Shqiperia eshte vend antar i EITI dhe duhet ti plotesoj disa kushte. Ne kemi komunikuar me drejtoreshen dhe i kemi thene qe per shqiperine standarte jane shume me te larta se sa per nje vend aziatik apo afrikan sepse kerkesat per ne jane shume me te medha sespse eshte Norvegjia dhe Shqiperia ne Europe. Me Norvegjine nuk merremi se ata i kane standartet po per ne ata na shohin me nje lupe tjeter se Azerbaxhani qe e shohin me lupe tjeter. Pra lupa per ne eshte shume here me e forte dhe me e madhe dhe kete duhet tia transmetojme atyre, ne duhet ti themi politike beresve tone.

z. Përparim Alikaj Kjo duhet pare edhe te shtetet e tjera qe jane antare, si eshte rregulli ne shtet te tjera? ..A ndahet keshtu?

z. Ilir Aliaj Ky eshte nje parim baze. Dhe shtetet e tjera nuk kane standartin qe kerkon Shqiperia per te pasur, norvegjia e ndan kurse Azerbajxhani rajoni i ka vendosur kryq, ose Kazakistanit te mos flasim kjo dihet, ne kerkojme tjeter gje ata kerkojne tjeter gje.

z. Mehmet Hasalami Ne mendojme qe ketu bashkarisht te shtojme dicka lidhur me precizimin, se cfare kerkon ligji, cfare kerkon udhezimi, kush jane hapesirat pastaj bejme ndonje ndryshim apo propozim qe duhet dhe te shenohet ne programin e punes 2014. A jeni dakort te shtohet dhe te precizohet detyre per ta percaktuar edhe ne te japing materialin e dokumentuar.

z. Bislim Boshnjaku, sherbimi gjeologjik. Une kam dicka tjeter per te thene, mendoj qe per periudhen 2014 struktura jone e monitorimit, vrojtimit dhe studimit e subjekteve qe kryejne aktivitet minerar ishte mire te ishin te ndare ne dy grupe...

Sepse kane dy specifika te ndryshme njera me tjeteren. Gjate monitorimit, do kene parametra te tjere vrojtiminiveli I vrojttimeve, monitorimeve te standarteve mendoj qe do nxjerri

konkluzione shume te mira seose kemi koncesione qe kane ..nuk kane bere asnje pune....keshtu do dali....kete propozim kam.

Dhe nje pyetje tjeter, rigjenerimi, ringritja sit e thuash e faqes se institucionit , te shihet mundesia te qe te behet nje faqe dhe me dinjitoze te burimeve ekzistuese natyrore duke eshoqeruar me aspektin e industrisse nxjerrese. Pra a do te kte hapsira dhe te dhena paraqitje me perfaqesuese dhe dinjitoze te burimeve perfaqesuse natyrore te shoqeruar ne aspektin e industrise nxjerrese ...kjo per mua do te ishte shume positive , per permiresimin e paraqitjes nga niveli I burimeve qe kemi deri te niveli

znj. Dorina Çinari Mund te na dergosh nje propozim, edhe une do ta ndaj me ata drejtuesit e EITI-it nese ne mund ta perfshijme ndonje aktivite komunikimi se eshte ne objektivat EITI por eshte ne nje standart me te larta, te lutem na dergo nje propozim me shkrim.

